

AKT THEMELIMI IRRJETIT PERIFERIK TE SINDIKATAVE TE ENERGIJE TE EVROPES JUGLINDORE

Sot ne Halkidiki me 30/09 2006 ditën e Shtunë përfaqësuesit e organizatave sindikaliste të energjisë , u mbledhën , në mbledhjen e sotme dhe vendosën shkriren e rrjeteve ekzistuese dhe krijimin e Rrjetit me emrin " RRJETI PERIFERIK I SINDIKATAVE TE ENERGIJE TE EVROPES JUGLINDORE " , në të cilin përfshihen sindikata të Energjisë Elektrike, të Naftës dhe të Gazit Natyror , të burimeve të tjera të Energjisë , të Metaleve dhe të Lendeve Kimike në Evropën Juglindore dhe aprovoi Statutin :

Rrjeti Periferik i Sindikatave të Energjisë të Evropës Juglindore :

1- Lufton për rruajtjen e Paqes, kontribuon në zhvillimin e miqësisë dhe të bashkëpunimit midis popujve dhe vendeve të Evropës Juglindore .

2- Është vazhdimisht kundër dallimit racia , fetar , dhe çfarëdo forme tjetër të këtij dallimi .

3- Objekti strategjik i Rrjetit Periferik është mbajtja e e interesave të punonjësve dhe të burimeve të pasura prodhuese të Evropës Juglindore .

4- Objekti i rëndësishëm dhe detyrë e rëndësishme e Rrjetit Periferik të Sindikatave të Energjisë të Evropës Juglindore është që të jetë partner i barabartë në dialog me Këshillin e Ministrave , të Komunitetit të Energjitikës , dhe bashkëbisedues i respektueshëm me Komisionin Kompetent të Evropës së Bashkuar .

5- I propozon Këshillit të Ministrave të Komunitetit të Energjitikës nënshkrimin e Kontrates së përbashkët Periferike që do të obligojë qeveritë e vendeve përkatëse të Evropës Juglindore

6- Lufton me konsekuencë kundër shkrires së Organizmave Publike dhe kundër privatizimit të ndermarjeve me dobi të pëgjirshme .

7 - Kërkon nga punëdhënësit dhe nga qeveritë zbatimin dhe respektimin e Marrëveshjeve Nderkombëtare të Punes që kanë të bëjnë me të drejtat e punonjësve dhe të organizatave sindikaliste .

8- Ndermjeteson dhe nderhyn në zgjidhjen e kontradiktave që ekzistojnë mes Organizatave Sindikaliste të antareve të Rrjetit dhe të Qeverive të vendeve të zonës sone .

9- Ndjek , studjon dhe reagon në kohë dhe me dinamizëm në zhvillimet Evropiane dhe botërore në sektorin e energjisë

10- Bashkëpunon me PSI, ICEM, EPSU, EMCEF dhe me Organizata të tjera Sindikaliste Evropiane dhe nderkombëtare .

11- Con përpara bashkëpunimin e Sindikatave në sektorin e Kulturës , të sporteve , të ekologjisë , të të drejtave njëzore dhe të barazisë së gruas me burin .